

Vendim nr.224, datë 26.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 26.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 35 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **AGRON TANUSHI**, përfaqësuar nga avokati Përparim Noka, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1328 (30-2023-4360), datë 26.07.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2026-15, datë 15.01.2026 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*), në datën 15.09.2020 ka regjistruar procedimin penal nr. 5776 (*procedimi penal nr.5776/2020*) për kryerjen e veprave penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 79/c dhe 278, paragrafi i tretë, të Kodit Penal (KP). Pas kryerjes së veprimeve hetimore, Prokuroria e Tiranës i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq në ngarkim të kërkuesit, duke e akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 79/c dhe 278, paragrafi i katërt, të KP-së.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtari i hetimeve paraprake, me vendimin nr. 2541 akti, datë 16.12.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe dërgimin për gjykim në gjykatën kompetente të procedimit penal nr. 5776/2020, për veprat penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 79/c dhe 278, paragrafi i tretë, të KP-së në ngarkim të kërkuesit [...]. Sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pandehuri (kërkuesi) dhe mbrojtësi i tij në përfundim të seancës paraprake kërkuar që të shënohet në procesverbal kërkesa për gjykim të shkurtuar, por për shkak se ajo nuk u paraqit në momentin e duhur procedural, nuk mund të merret vendim për pranimin ose rrëzimin e kësaj kërkesë, duke pasur parasysh edhe faktin se i pandehuri, i vetëdijshtëm që gjykimi i shkurtuar nuk lejohet për veprën penale për të cilën akuzohet, kërkoi vetëm që të shënohet në procesverbal kërkesa e tij për gjykim të shkurtuar, në mënyrë që të ketë një vendimarrje nga ana e gjykatës që do të gjykojë themelin e çështjes.

3. Në gjykimin në themel të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3011, datë 15.12.2022, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje”, të parashikuar nga neni 76 i KP-së dhe dënimin e dënimit e tij me 20 (njëzet) vjet burgim. Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i katërt, të KP-së dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, bashkimin e dënimeve dhe dënimin e tij me 23 (njëzet e tre) vjet burgim.”. Kjo çështje është gjykuar me procedurën e gjyimit të zakonshëm, pasi, sipas gjykatës së shkallës së parë, neni 403 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) nuk lejon kërkesën për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm dhe vepra penale e

parashikuar nga neni 79/c, për të cilën akuzohej kërkuesi, parashikonte dënim të përjetshëm. Në vlerësimin e themelit të çështjes, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se kualifikimi ligjor i rrethanave të faktit të bëra nga organi i akuzës për veprën penale “Vrasja për shkak të rrethanave familjare”, të parashikuar nga neni 79/c i KP-së, në ngarkim të të pandehurit (kërkuesit), është i pabazuar në ligj e në prova, pasi në momentin kur ka ndodhur vrasja e viktimës, kjo e fundit nuk ka qenë as kunatë dhe as bashkëjetuese, ose ish-bashkëjetuese e tij, sikurse pretendon prokurori. Po sipas gjykatës së shkallës së parë, duke qenë se një ndër elementet thelbësore të kualifikimit të veprës penale, sipas nenit 79/c të KP-së, është cilësia e posaçme e viktimës në raport me autorin e veprës dhe, në rastin konkret, ky raport i posaçëm mungon, pasi viktimja nuk ka pasur as cilësinë e kunatës dhe as cilësinë e bashkëjetueses, ose të ish-bashkëjetueses të të pandehurit në momentin e kryerjes së veprës penale, kualifikimi ligjor i bërë nga organi i akuzës për vrasjen e kryer nga i pandehuri është i gabuar dhe i pabazuar në ligj e në prova. Në vlerësimin e çështjes, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se nga çmuarja në tërësi dhe në unitet midis tyre të provave të administruara në gjykim, rezulton e provuar, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, ekzistenca e faktit penal në ngarkim të kërkuesit dhe fajësia e tij për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje”, të parashikuar nga neni 76 i KP-së. Ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka bërë ankim, ndër të tjerë, edhe kërkuesi.

4. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 1328 (30-2023-4360), datë 26.07.2023, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit gjykatës së shkallës së parë me këtë ndryshim: “Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim”, të parashikuar nga neni 78, paragrafi i parë, i KP-së dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit të tij me 25 vjet burgim. Në bazë të nenit 55 të KP-së, bashkimin e dënimeve në një të vetëm prej 28 vjetësh burgim.””. Në vlerësimin e gjykatës së apelit, pretendimi i kërkuesit për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar është e pabazuar në ligj, pasi, sipas nenit 403 të KPP-së, në fazën e kërkesave paraprake, kërkesa për të proceduar në gjendjen që janë aktet është bërë nga i pandehuri (kërkuesi) dhe mbrojtësi i tij, por ajo nuk është marrë në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë, për shkak se është depozituar më vonë dhe jo në momentin e duhur procedural. Sipas gjykatës së apelit, referuar procesverbalit të seancës gjyqësore (seanca paraprake), rezulton se kërkuesi dhe mbrojtësi i tij në momentin e kërkesave paraprake të pyetur nga gjykata nuk kanë bërë kërkesë për gjykim të shkurtuar dhe as kanë depozituar me shkrim një të tillë në sekretari, por në konkluzionet përfundimtare i kanë qëndruar kërkesës së tyre për kthimin e çështjes për hetime dhe në rast se gjykata nuk e merr në konsideratë, të shënohet në procesverbal kërkesa për gjykim të shkurtuar. Në këtë kuptim, gjykata e apelit ka vlerësuar se vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë për mospranimin e

kërkesës për gjykim të shkurtuar është e drejtë dhe e bazuar, pasi jo vetëm që është konstatuar se nuk është paraqitur në përputhje me rregullat procedurale, por dhe se akuza e ngritur nga prokuroria, parashikon dënim me burgim të përjetshëm, vepër penale për të cilën nuk lejohet gjykimi i shkurtuar. Lidhur me themelin e çështjes, gjykata e apelit ka arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në interpretim dhe në zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe material penal për kualifikimin ligjor të veprës penale në ngarkim të të pandehurit, si dhe në caktimin e masës së dënimit, pasi në analizë të provave, burimeve të provave dhe fakteve kërkuesi, me veprimet e tij kriminale aktive, ka konsumuar elementet e veprës penale “Vrasja me paramendim”, të parashikuar nga neni 78, paragrafi i parë, i KP-së, për të cilën duhet të deklarohet fajtor. Sipas asaj gjykate nga analiza në tërësi e provave del qartë se vrasja e viktimës ishte paramenduar nga i pandehuri dhe nuk ishte rrjedhojë e një konflikti të çastit mes tyre. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs, ndër të tjerë, edhe kërkuesi.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2026-15, datë 15.01.2026, ka vendosur mospranimin e rekurseve, pasi nuk përmbanin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Lidhur me pretendimin e kërkuesit, për zbatimin e gabuar nga gjykatat të nenit 406, paragrafi i parë, të KPP-së, Kolegji Penal ka vlerësuar se ai nuk qëndron, pasi ndonëse kërkesa për gjykim të shkurtuar është paraqitur në seancë paraprake, si dhe se ndalimi i aplikimit të gjykimit të shkurtuar për shkak të veprës nuk ka qenë më ekzistent me dhënien e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, i gjykuari (kërkuesi), gjatë zhvillimit të seancës paraprake, ka depozituar parashtrime dhe kërkesa me shkrim, në të cilat kërkon shprehimisht kryerjen e disa veprimeve hetimore shtesë dhe marrjen e provave të reja. Sipas Kolegjit Penal, i gjykuari (kërkuesi) ka kërkuar administrimin e materialeve për kallëzimet e shtetasve A.T., A.T. dhe B.T. të regjistruara në Prokurorinë e Tiranës, si dhe të çështjeve civile të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë ndërgjyqëse të pandehurin e familjarët e tij, nga njëra anë, dhe viktimën, nga ana tjetër. Po kështu, Kolegji Penal ka arsyetuar se, sipas të gjykuarit, nuk janë nxjerrë dhe nuk janë kryer ekspertime për regjistrimet video që ai ka bërë me anë të telefonit të tij celular, duke evidentuar në vazhdimësi veprimet e viktimës të kryera ndaj tij dhe familjarëve të tij, si dhe shkëmbimi i bisedave ose i mesazheve, si dhe ka paraqitur kërkesë për kryerjen e një riekspertimi psikiatrik ligjor. Në këtë kuptim, Kolegji Penal ka vlerësuar se i gjykuari qartësisht ka bërë kërkesa për marrjen e provave të reja gjatë zhvillimit të seancës paraprake dhe në vijim, gjatë gjykimit të çështjes në themel, ka bërë kërkesa për marrjen e provave duke kërkuar thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të një numri të caktuar individësh, kryerjen e një ekspertimi teknik për regjistrimet video të bëra prej tij etj. Për sa i

përket pretendimit për kualifikimin juridik të veprës penale, Kolegji Penal ka arsyetuar se vlerësimi i provave dhe fakteve është prerogativë e gjykatave të faktit dhe ndërhyrja e Gjykatës së Lartë përligjet vetëm në rastet e përcaktuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas atij kolegj, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk mund të rivlerësojë provat dhe faktet e çështjes, por mund të verifikojë vetëm nëse gjykatat e faktit kanë zbatuar drejt ligjin material dhe procedural në bazë të fakteve të cilësuar si të provuara prej tyre. Në këtë kuptim, Kolegji Penal ka vlerësuar se analiza e bërë nga gjykata e apelit në interpretim të provave dhe të fakteve paraqitet e plotë dhe e arsyetuar mjaftueshëm, duke identifikuar elementet përbërëse të figurës së veprës penale të vrasjes me paramendim. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, gjykata e apelit ka bërë një analizë të plotë të kriterëve të caktimit të dënimit në përputhje me nenin 47 të KP-së, duke marrë në konsideratë rrezikshmërinë shumë të lartë shoqërore të veprës penale në rrethanat konkrete, mënyrën dhe formën e kryerjes së veprës, rrezikshmërinë e autorit, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga nenet 48, 49 dhe 50 të KP-së.

6. Në datën 30.04.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

II

Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, duke pretenduar se i është cenuar:

7.1. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjykata e apelit ka gabuar në kualifikimin ligjor të veprës penale, pa u bazuar në prova dhe në ligj. Ajo gjykatë ka bërë vlerësim të provave dhe të fakteve përtej asaj që lejon ligji, duke dhënë u dhënë atyre një vlerë të paqenë, në kundërshtim me nenet 152 dhe 153 të KPP-së.

7.2. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykata e apelit dhe më pas Gjykata e Lartë, në mënyrë të gabuar dhe në kundërshtim me parimet kushtetuese, nuk kanë zbatuar reduktimin e dënimit sipas parashikimeve të nenit 406 të KPP-së, duke qenë se nga të dyja ato gjykata është pranuar fakti se i pandehuri nuk ka kryer veprën penale për të cilën nuk lejohet gjykim i shkurtuar.

7.3. *Parimi i ligjshmërisë dhe i mosdënimit pa ligj*, pasi vendimi i gjykatës së apelit është marrë në shkelje të nenit 47 të KP-së, për shkak se nuk ka mbajtur në konsideratë rrethanat tërësore të analizës që i bën procesit të caktimit të dënimit. Të njëjtën shkelje ka bërë dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Gjykata e apelit

nuk ka zbatuar dhe nuk ka respektuar ligjin procedural penal në lidhje me nenin 383 të KPP-së, pika 1, shkronja “ç”, duke mos vlerësuar dhe mos analizuar provat në tërësi, në lidhje me njëra-tjetrën.

7.4. *E drejta e aksesit, e drejta e ankimit dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit nuk pasqyron qartë procesin logjik të çmuarjes së provave, sipas nenit 152 të KPP-së. Në këtë kuptim, Kolegji Penal duhej të kishte evidentuar se vendimi i gjykatës së apelit paraqiste mangësi në arsyetim, të cilat nuk lidheshin me vlerësimin e ligjshmërisë së marrjes së provave, por me mënyrën e vlerësimit të saj në tërësi dhe në raport me provat e tjera, duke cenuar standardet e nenit 152 të KPP-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimimin e kërkesit*

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret paraprake të legjitimitetit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë, si pasojë, moskalimin e saj në seancë plenare.

10. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitetit për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues në drejtim të pretendimeve të

parashtruara nga kërkuesi, në mbështetje të ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se, ndër të tjera, ai ka pretenduar se i janë cenuar *e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, parimi i sigurtisë juridike, parimi i ligjshmërisë dhe mosdënimit pa ligj*, si dhe *e drejta e aksesit, e drejta e ankimit dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

11. Në lidhje me pretendimet për cenimin e *të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, parimit të ligjshmërisë dhe mosdënimit pa ligj dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, kërkuesi, në thelb, ka argumentuar se gjykata e apelit ka bërë vlerësim të provave dhe të fakteve përtej asaj që lejon ligji, duke u dhënë atyre një vlerë të paqenë, në kundërshtim me nenet 152 dhe 153 të KPP-së. Sipas kërkuesit, vendimi i gjykatës së apelit është marrë në shkelje të nenit 47 të KP-së dhe ajo gjykatë nuk ka zbatuar e respektuar ligjin procedural penal, duke mos vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi në lidhje me njëra-tjetrën. Po sipas kërkuesit, gjykata e apelit nuk pasqyron qartë procesin logjik të çmuarjes së provave, sipas nenit 152 të KPP-së, dhe kjo mangësi nuk është evidentuar as nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke u cenuar kështu standardet e nenit 152 të KPP-së.

12. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar vazhdimisht se vlerësimi provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, si dhe të vlerësimit të provave dhe të fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Për sa më lart, referuar argumenteve të sjella nga kërkuesi në mbështetje të pretendimeve të tij për cenimin e *të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, parimit të ligjshmërisë dhe mosdënimit pa ligj*, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Kolegji konstaton se ato, në thelb, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, mbi bazën e të cilave gjykatat kanë arritur në përfundimin e tyre për deklarimin fajtor të tij për veprat penale për të cilat është akuzuar, si dhe me interpretimin dhe zbatimin e ligjit material e procedural penal, të cilat, si të tilla, nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në kushtet që kërkuesi nuk ka sjellë ndonjë argument konkret kushtetues për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor për këto pretendime, dhe në kushtet që ai nuk

ka arritur të provojë cenimin e të drejtave kushtetuese për shkak të mënyrës sesi kanë vepruar gjykatat në zgjidhjen e çështjes konkrete, ato (pretendimet) mbeten me natyrë ligjore, ndaj nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për to.

14. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit, për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, Kolegji vëren se ai ka argumentuar se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë aplikuar ndaj tij reduktimin e dënimit sipas parashikimeve të nenit 406 të KPP-së, duke qenë se prej tyre është pranuar fakti se nuk ka kryer veprën penale për të cilën nuk lejohet gjykimi i shkurtuar. Bazuar në natyrën dhe në thelbin e këtij pretendimi, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës (*shih vendimin nr. 26, datë 29.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*), Kolegji, në vijim, do ta analizojë atë në drejtim të *parimit të mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

15. Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*), e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar (*shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, për sa i takon ritit procedural të gjyqimit të shkurtuar, Gjykata ka pohuar se ai (gjykimi i shkurtuar) nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit dhe, në rast se ai ka dyshime mbi këtë vlerësim, kjo mjafton që të rrëzojë kërkesën e të pandehurit (*shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Ndërsa në lidhje me karakteristikat e gjyqimit të shkurtuar, i cili hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse gjykata e zakonshme çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa iu nënshtruar provat debatit gjyqësor dhe pa marrë prova të reja, vlerësim i cili konsiston në bindjen e brendshme të gjyqtarit, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili, nëse ka dyshime për këtë vlerësim, mund të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme, duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 6 datë 22.02.2022; nr. 5, datë 02.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa i takon ndarjes së detyrave midis juridiksionit kushtetues dhe atij të gjyqësorit të zakonshëm, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se ajo ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 34, datë 17.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa i përket kërkesës për gjykim të shkurtuar, neni 403 i KPP-së parashikon se ajo paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm në seancën paraprake ose në seancë gjyqësore kur procedohet sipas nenit 400 dhe paragrafit 3, të nenit 406/ç, të këtij kodi, me pasojë mospranimin (*pika 1*) dhe se nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm (*pika 2*).

20. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji konstaton se kërkuesi është akuzuar nga organi i akuzës për kryerjen, ndër të tjera, të veprës penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të parashikuar nga neni 79/c i KP-së, dispozitë e cila parashikon si dënim maksimal burgimin e përjetshëm. Po kështu, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për nevoja të këtij gjykimi kushtetues, rezulton se kërkuesi në parashtrimet e tij të paraqitura në gjykatën e shkallës së parë, gjyqtarit të hetimeve paraprake, ka pretenduar se nuk janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të kërkuara prej tij, konkretisht pyetja e disa dëshmitarëve dhe administrimi i kallëzimeve të bëra nga disa shtetas etj., të cilat, sipas tij ishin të nevojshme të kryheshin. Po kështu, në parashtrimet e tij mbrojtësi i kërkuesit ka ngritur pretendime dhe për cilësimin juridik të veprës penale për të cilën ai akuzohej. Referuar procesverbalit të seancës paraprake të datës 16.12.2021, të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, rezulton se mbrojtësi i kërkuesit i ka kërkuar gjyqtarit të hetimeve paraprake të asaj gjykate kthimin e akteve për plotësim të hetimeve, duke përcaktuar drejtimin e tyre dhe aktet që duhen kryer. Po sipas mbrojtësit të kërkuesit, nëse kjo kërkesë nuk konsiderohet e drejtë, atëherë të shënohet në procesverbal kërkesa për gjykim të shkurtuar.

21. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtari i hetimeve paraprake, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes në gjykatën kompetente për veprat penale për të cilat akuzohej kërkuesi, duke arsyetuar në vendimin e saj se kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk mund të pranohet, pasi nuk u paraqit në momentin e duhur, dhe se gjykimi i shkurtuar nuk lejohet për veprën penale për të cilën ai akuzohet, sepse parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe se kërkuesi kërkoi vetëm që të shënohet në procesverbal kërkesa e tij për gjykim të shkurtuar, në mënyrë që të ketë një vendimmarrje nga ana e gjykatës që do të gjykojë themelin e çështjes (*shih paragrafin 2 të këtij vendimi të Kolegjit*).

22. Referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore të gjykimit të themelit të çështjes së kërkuesit, rezulton se mbrojtësi i tij nuk e ka përsëritur kërkesën për gjykim të shkurtuar, por ai ka ngritur pretendime për cilësimin juridik të veprës penale për të cilën ai akuzohej (kërkuesi), si dhe ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë t'i nënshtrohen debatit gjyqësor provat e paraqitura nga organi i akuzës, duke kërkuar gjithashtu pyetjen e dëshmitarëve të kërkuar nga organi i akuzës (procesverbali i seancës gjyqësore, datë 21.04.2022). Në seancën gjyqësore të zhvilluar në datën 11.05.2022 mbrojtësi i kërkuesit ka përsëritur kërkesën për thirrjen e disa dëshmitarëve, si dhe ka kërkuar që të kryhet një ekspertim teknik për regjistrimin video që ka bërë kërkuesi me anë të telefonit të tij celular dhe administrimin e disa provave të tjera. Në vijim, referuar procesverbaleve të seancave të tjera gjyqësore, nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur kërkesë për t'u gjykuar me ritin e gjykimit të shkurtuar.

23. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me procedurën e gjykimit të zakonshëm, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale "Vrasja me dashje" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit", të parashikuara nga nenet 76 dhe 278, paragrafi i katërt, të KP-së dhe dënimin e tij përfundimisht me 23 (njëzet e tre) vjet burgim". Sipas asaj gjykate, neni 403 i KPP-së nuk lejon kërkesën për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm dhe vepra penale e parashikuar nga neni 79/c, për të cilën kërkuesi akuzohej, parashikonte dënim me burgim të përjetshëm (*shih paragrafin 3 të këtij vendimi të Kolegjit*).

24. Ndërkohë, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjykatës së shkallës së parë, duke ndryshuar veprën penale në ngarkim të kërkuesit, duke e cilësuar atë si "Vrasja me paramendim", të parashikuar nga neni 78, paragrafi i parë, i KP-së, dhe dënimin e tij me 25 vjet burgim për këtë vepër. Në bashkim të dënimeve, gjykata e apelit e ka dënuar kërkuesin me 28 vjet burgim. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për gjykim të shkurtuar, gjykata e apelit ka arsyetuar se ajo është e pabazuar në ligj, pasi rezulton se ai dhe mbrojtësi i

tij, në momentin e kërkesave paraprake, të pyetur nga gjykata, nuk kanë bërë kërkesë për gjykim të shkurtuar dhe as kanë depozituar me shkrim një të tillë në sekretari, por në konkluzionet përfundimtare i kanë qëndruar kërkesës së tyre për kthimin e çështjes për hetime. Në këtë kuptim, gjykata e apelit ka arsyetuar se vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar është e drejtë dhe e bazuar, pasi jo vetëm që është konstatuar se nuk është paraqitur në përputhje me rregullat procedurale, por edhe se akuza e ngritur nga prokuroria, me të cilën është dërguar nga gjyqtari i seancës paraprake, parashikon dënim me burgim të përjetshëm, vepër penale për të cilën nuk lejohet gjykimi i shkurtuar (*shih paragrafin 4 të këtij vendimi të Kolegjit*).

25. Për rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, duke arsyetuar, ndër të tjera, se pretendimi i tij për kërkesën për gjykim të shqyrtuar nuk është e bazuar, pasi ai qartësisht ka bërë kërkesa për marrjen e provave të reja gjatë zhvillimit të seancës paraprake dhe në vijim gjatë gjykimit të çështjes në themel, ka bërë kërkesa për marrjen e provave, duke kërkuar thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të një numri të caktuar individësh, kryerjen e një ekspertimi teknik për regjistrimet video të bëra prej tij etj. (*shih paragrafin 5 të këtij vendimi të Kolegjit*).

26. Për sa më lart, Kolegji konstaton se kërkuari nuk e ka kërkuar në mënyrë të veçantë gjykimin e shkurtuar gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, ku është shqyrtuar themeli i çështjes së tij, sipas nenit 403 të KPP-së, por e ka bashkuar atë me kërkesat e tij për marrje provash të reja gjatë zhvillimit të seancës paraprake. Po kështu, Kolegji vëren se gjatë gjykimit të themelit të çështjes së tij, ai ka kërkuar marrjen e provave të tjera dhe thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të disa individëve ose kryerjen e ekspertimit për regjistrimet video të bëra prej tij, kërkesa të cilat nuk lejojnë ritin e gjykimit të shkurtuar, por procedurën normale të gjykimit. Në këtë drejtim, Kolegji konstaton gjithashtu se kërkuari ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e zakonshme për kërkesën për gjykim të shkurtuar, arsyetim i cili nuk rezulton të jetë alogjik ose haptazi i paarsyeshëm, pra që të vërë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për gjykim të drejtë, si dhe nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

27. Në këndvështrim të sa më lart, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, Kolegji vlerëson se nuk është i nevojshëm analizimi i mëtejshëm i plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të ankimit kushtetues të individual të kërkuarit.

28. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuarit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.